



#Inclusive Albania/
#ShqipëriaGjithëpërfshirëse

Njoftim Punësimi

(Termat e Referencës – Shofer
për Qendrën Komunitare dhe shërbimin në familje për fëmijët me aftësi të kufizuara, Shijak)

Titulli i projektit	“Shërbime Sociale të Integruara për Gjithëpërfshirjen e Fëmijëve dhe të Rinjve me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Shijak”
Kohëzgjatja	28 muaj (1 Qershor 2022 – 30 Shtator 2024)
Financuar nga	BE në kuadër të Programit mbështetje për Përfshirjen Sociale në Shqipëri
Nr. i kontratës	IPA/2022/433-142
Zbatuesi kryesor	Bashkia Shijak
Partnerë në zbatim	Shoqata “Ndihmoni Jetën” Fondacioni Down Syndrome Albania
Qëllimi kryesor i projektit	Projekti do të kontribuojë drejt përfshirjes sociale dhe përmirësimit të cilësisë së jetës për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në Bashkinë Shijak.
Përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit	150 fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara 300 prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara 140 profesionistë (ofrues shërbimi të drejtpërdrejtë dhe profesionistë të tjerë).

Prezantimi

Bashkia Shijak, në partneritet me Shoqatën “Ndihmoni Jetën” dhe Fondacionin Down Syndrome Albania dhe me mbështetjen financiare nga Bashkimi Evropian, ka filluar implementimin e Projektit “Shërbime Sociale të Integruara për Gjithëpërfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në Bashkinë Shijak”, i cili implementohet në Bashkinë Shijak.

Projekti është dizenuar t’ju vij në ndihmë fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në Bashkinë Shijak. Impakti që projekti do të ketë në komunitetin e personave me aftësi të kufizuara të Bashkisë Shijak është **krijimi i një modeli të integruar të të gjithë shërbimeve të përkujdesit për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në Bashkinë Shijak.**

*Në kuadër të implementimit të këtij projekti, Bashkia Shijak në bashkëpunim me partnerët në zbatim të projektit Shoqatën “Ndihmoni Jetën” dhe Fondacioni Down Syndrome Albania, kërkon të punësojë **1 Shofer të kualifikuar (me kohë të plotë) e/i cili do të jetë pjesë e sfatit të Qendrës Komunitare për personat me aftësi të kufizuara Shijak dhe do të ofroj asistencën e tij/saj për shërbimin në familje për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara të targetuara nga ky projekt.***



Funded by
the European Union

Përgjegjësitë specifike:

1. Realizon transportin e stafit të qendrës pranë përfituesve të shërbimit sipas një kalendari të paracaktuar.
2. Siguron transportin në kohë të stafit pranë përfituesve të shërbimit.
3. Kujdeset për materialet didaktike të stafit ndërkohë që stafi është në shërbim.
4. Kujdeset dhe merr masa në kohë për mjetin e punës (makinen) në lidhje me:
 - periudhat e përfundimit të siguracionit,
 - periudhat e taksave,
 - kontrolleve periodike teknike,
 - sigurimin e dokumentacionit të duhur për mjetin sipas qëllimit të përdorimit.
5. Siguron që mjeti i punës të jetë në gjendje optimale teknike dhe higjienike përgjatë periudhës së përdorimit.
6. Në bashkëpunim me stafin e qendrës koordinon dhe lehtëson aktivitetet ndërgjegjësuese me fëmijët në komunitet.

Kualifikimi:

- Të ketë Leje drejtimi / patentë të klasit B.
- Të ketë eksperiencë pune si shofer për transport fëmijësh.
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.

Kohëzgjatja:

20 muaj duke filluar nga dt. 1 Shkurt 2023.

Vendndodhja

Qendra komunitare për personat me aftësi të kufizuar, Shijak.

Supervizimi:

Shoferi do të supervizohet nga Manaxheri i Qendrës dhe Manaxheri i Projektit.

Kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kriteret e parashkuara në këto Terma Reference, mund të dorëzojnë dokumentat e mëposhtëm brenda **dt.25 Janar 2023, ora 17:00:**

- Letër motivimi që shpjegon motivimin tuaj për të aplikuar për këtë pozicion dhe se si ju i plotësoni kriteret.
- CV e detajuar.
- Kopje e lejes së drejtimit/liçences për ushtrimin e profesionit të Shoferit.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për fazën e intervistës do të njoftohen.

Aplikimet tuaja mund ti dërgoni në këtë adresë e-maili: shijaksociale@gmail.com dhe : info@shijak.gov.al, ose në adresën postare: Bashkia Shijak, Lagja Erzen, Shijak, Durrës, Shqipëri.

Gjatë procesit të vlerësimit do të kenë prioritet aplikuesit nga Bashkia Shijak.